

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kaos në Ceuta/ Mijëra emigrantë vërshojnë në rrugë për një vend në kampin e ri - Informohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/kaos-ne-ceuta-mijera-emigrante-vershojne-ne-rruge-per-nje-vend-ne-kampi-n-e-ri/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 14:32:45 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 14:23:47 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	bc032603355cf629a04940858b1a6b5391ceea47b7cc621b96171acdbe5292b0
TEKSTI	74a408feb6ad6a79e35078d7ec938b8b910a8198e4f30147d1cc06e0e8934efa
PAMJA	c05189e7b3c7aa1387009393b0a37ecb681ab9109354a7ca4193c7bc41c25ca3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	34805e63d07d18d2e3f922f20a88e26b4cb6d1a12c02431e88c22f3c3f3a1399
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	565145c81569d96b39079f1db9ed9e378c0d0ec132a26687d139f465bf7be21b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/34805e63d07d18d2e3f922f20a88e26b4cb6d1a12c02431e88c22f3c3f3a1399>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » Kaos në Ceuta/ Mijëra emigrantë vërshojnë në rrugë për një vend në kampin e ri

BOTË

Demo

Kaos në Ceuta/ Mijëra emigrantë vërshojnë në rrugë për një vend në kampin e ri

SEPTEMBER 18, 2026



Situata është tensionuar të premten në Ceuta të Spanjës, ku mijëra emigrantë kanë dalë në rrugët e qytetit dhe janë drejtuar në mënyrë masive drejt një qendre të re strehimi të ngritur pranë portit.

Autoritetet spanjolle kishin nisur një operacion për transferimin e emigrantëve që prej javësh jetonin në kushte të vështira, në plazhe dhe në strehimore të improvizuara. Por procesi u shoqërua me kaos, pasi një numër i madh personash nxituan drejt kampit të ri për të siguruar një vend.

Operacioni nisi rreth orës 06:30, sipas kohës lokale. Një burim qeveritar spanjoll në Ceuta tha se policia ndërhyri për të vendosur situatën nën kontroll, ndërsa mediat lokale raportuan për angazhimin e Policisë Kombëtare dhe njësisë të kontrollit të trazirave. Ka gjithashtu raportime për përdorimin e gazit lotsjellës.

Pamjet e publikuara nga vendngjarja tregojnë turma të mëdha emigrantësh duke vrapuar nëpër rrugët e qytetit. Në disa prej videove, njerëzit shfaqen duke bërë turrë dhe festuar ndërsa drejtohen drejt qendrës së re të akomodimit.

Kampi i ndërtuar pranë portit ka kapacitet për rreth 1,700 persona dhe është pajisur me tenda, shtretër dhe dushe. Qeveria spanjolle ka vendosur të vijojë procesin e transferimit, pavarësisht kundërshtimeve të shprehura nga autoritetet lokale.



Kriza në Ceuta nisi të përkeqësohej në fund të korrikut, kur dhjetëra mijëra emigrantë kaluan nga Maroku drejt enklavës spanjolle në Afrikën e Veriut. Shumica e tyre janë kthyer, por sipas autoriteteve lokale, rreth 13 mijë persona ndodhen ende në zonë, ndërsa shumë prej tyre janë detyruar të qëndrojnë në plazhe dhe strehimore të improvizuara.

Postimet e reja

Kaos në Ceuta/ Mijëra emigrantë vërshojnë në...

SEPTEMBER 18, 2026

Sulmet në Arabinë Saudite/ Goditet një...

SEPTEMBER 18, 2026

Ministri Hoxha takon përfaqësuesin e ri të...

SEPTEMBER 18, 2026

Agjentët e DEA-s takim sekret në Buenos Aires,...

SEPTEMBER 18, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 15, 2026

Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznese të paktën 1-vjeçare

Pas shpalljes së listës së fituesve të "Grant 2026" kanë nisur të dalin rastet ku...

Skema sesi IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që ju merr konsumatorëve me interesa mbi 30%!

Skandal me sallamin në dyqanet Conad, thirrje konsumatorëve ta kthejnë mbrapsht

6 milionë euro të Startup Albania: Përfituesit, qokat dhe "problematikët"

Na ndiq

Facebook

Instagram

Kryeministri spanjoll, Pedro Sanchez, është përballur me kritika për mënyrën se si qeveria ka menaxhuar situatën. Sanchez i ka hedhur poshtë akuzat për keqmenaxhim, duke argumentuar se shërbimet shtetërore u përballën me një numër mbërritjesh që tejkalonte kapacitetet e tyre.

Gjatë një daljeje televizive më 14 shtator, Sanchez pranoi se autoritetet ishin të mbingarkuara nga numri i emigrantëve që mbërritën në Ceuta. Ai deklaroi se synimi i qeverisë është që situata të jetë nën kontroll deri në fund të vitit, ndërsa u kërkoi durim rreth 84 mijë banorëve të qytetit.



Ndërkohë, janë ngritur pikëpyetje edhe nëse qeveria spanjolle ishte informuar paraprakisht për mbërritjen masive të emigrantëve.

Fillimisht, autoritetet deklaruan se nuk kishte pasur paralajmërime për atë që do të ndodhte. Më pas, qeveria publikoi 40 komunikime të deklasifikuara, sipas të cilave Qendra Kombëtare e Inteligjencës së Spanjës, CNI, kishte raportuar më 29 korrik për përpjekje të organizuara për të hyrë në Ceuta nga toka dhe deti.

Një prej komunikimeve i referohej edhe një thirrjeje në rrjetet sociale për një kalim masiv mbrëmjen pasuese. Sipas "Daily Mail", CNI ia kishte përcjellë informacionin edhe shërbimeve të inteligjencës marokene.

Megjithatë, Sanchez ka kundërshtuar interpretimin se këto komunikime përbënin një paralajmërim zyrtar për përmasat e ngjarjeve që pasuan.

Përveç krizës së strehimit, banorët e Ceutës kanë shprehur shqetësime edhe për sigurinë. Sipas raportimeve të mediave britanike, në zonë janë regjistruar incidente të dhunshme, sulme ndaj ushtarëve dhe raste të sulmeve seksuale.

Prokurorja e Ceutës, Silvia Rojas, ka folur për një "rritje eksponenciale" të kriminalitetit, duke iu referuar edhe rasteve të sulmeve seksuale dhe incidenteve ku janë përfshirë të mitur.

Ekspertë të sigurisë publike kanë paralajmëruar gjithashtu për rrezikun e përshkallëzimit të mëtejshëm të tensioneve në qytet.

Një tjetër shqetësim lidhet me kushtet sanitare në kampet e improvizuara. Një adoleshent nga Maroku është diagnostikuar këtë javë me linë e majmunëve dhe është vendosur në izolim, ku po merr trajtim. Ndërkohë, mes emigrantëve janë raportuar të paktën pesë raste tuberkulozi.

Presidenti rajonal i Ceutës, Juan Jesús Vivas, ka kërkuar më shumë mbështetje nga Bashkimi Evropian, duke e përshkruar situatën në qytet si një "tenxhere me presion" që mund të shpërthejë në çdo moment.

"Qyteti është krejtësisht i ndryshëm nga ai që ishte para kësaj ngjarjeje. Njerëzit e Ceutës e kanë humbur gëzimin dhe mënyra e tyre e jetesës është tronditur plotësisht", u shpreh Vivas para eurodeputetëve.



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radarlajme@gmail.com

Kontakt: +355689008000

Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator

Një ditë me surpriza në dashuri:
Horoskopi për të gjitha shenjat

Pak dramë, shumë ndjenja:
Horoskopi i dashurisë për këtë javë



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

raporto këtu